

## KUSHTET E PËRDORIMIT TË FAQES– FAQET E REGJISTRIMIT NE MIKROFAQE

Pajisjet Samsung Galaxy S9 ose S9+ të blera nga 23 prill deri 15 korrik 2018.

Para fillimit të procesit të regjistrimit për pajisjet Samsung Galaxy S9 ose Galaxy S9+ të blera nga 23 prilli deri më 15 korrik 2018, ju lutemi lexoni kushtet e përdorimit të faqes - mikrofaqe për regjistrimin e këtyre pajisjeve (në tekstin pasues referuar si 'Termat'):

1. Samsung Electronics Austria GmbH, (në tekstin pasues "Samsung") po organizon promovimin e pajisjeve Samsung Galaxy S9 dhe S9+ si pjesë e së cilës është prezente shtesa: Ushqyesi pa kabëll dhe 1 vit sigurimi në rast të dëmtimit të ekranit.

Ushqyesi pa kabëll do të jepet si dhuratë. Për kushtet e promovimit, sigurimit dhe regjistrimit vizitoni [www.samsungsp.eu](http://www.samsungsp.eu)

### 2. QËLLIMI DHE KOHËZGJATJA E REGJISTRIMIT TË PAJISJEVE

Samsung organizon regjistrimin e pajisjeve Samsung Galaxy S9 ose S9+ të blera nga data 23 prill deri më 15 korrik 2018, i cili bëhet përmes një faqeje të dedikuar interneti posaçërisht për këtë - [www.samsungsp.eu](http://www.samsungsp.eu). Kohëzgjatja e procesit të regjistrimit është nga data 23 prill 2018 deri 15 korrik 2018 dhe është e mundur të regjistrohen pajisjet e Samsung Galaxy S9 ose S9+ të blera vetëm nga data 23 prill deri më 15 korrik 2018. Çdo klient që regjistron pajisjen e tij sipas Termave në faqet/mikrofaqet e internetit të përgatitura posaçërisht për të do të marrë një ushqyes pa kabëll në adresën e tij pa kosto shtesë në periudhën prej 20 ditësh pune nga regjistrimi i suksesshëm i pajisjes.

Për përfitimet e sigurimit shikoni detajet në faqen e internetit [www.samsungsp.eu](http://www.samsungsp.eu)

### 3. KUSHTET PËR REGJISTRIMIN

Të drejtë për të regjistruar pajisjen Samsung Galaxy S9 ose S9+ e kanë të gjitha pajisjet Samsung Galaxy S9 ose S9+ në territorin e Republikës së Shqipërisë, të blera nga data 23 prill deri më 15 korrik 2018 në dyqanet e autorizuara nga Samsung:

Neptun Albania, Vodafone Albania, Telekom Albania, Globe AL, Smart Point, AZA Electronics, Go Tech

### 4. PROCEDURA E REGJISTRIMIT TË PAJISJES

Klienti duhet të regjistrojë pajisjen e blerë nga data 23 prilli deri më 15 korrik 2018, në mënyrë që të ketë të drejtë të marrë një ushqyes pa kabëll dhe një vit sigurimi në rast dëmtimi të ekranit. Ky regjistrim duhet të kryhet nëpërmjet mikrofaqes në faqen zyrtare të internetit [www.samsungsp.eu](http://www.samsungsp.eu)

Procesi i regjistrimit kërkon hyrjen e të dhënave personale të klientit për regjistrimin e suksesshëm.

Do të mblidhen të dhënat personale të klientëve: emri, mbiemri, adresa e e-mailit të blerësit, adresa e plotë e blerësit (kështu mund të dorëzohet ushqyesi pa kabëll), numri IMEI i pajisjes së blerë dhe

ngarkimi i faturës fiskale nga vendi i blerjes. Përveç të dhënave personale të lartpërmendura, mund të kërkohen edhe në të dhëna për modelin e mëparshëm të telefonit të konsumatorit, si dhe të dhënat për moshën e klientit, por mos futja e këtyre të dhënave shtesë nuk do të ketë ndikim. Duke klikuar butonin për të nisur të dhënat, klienti dorëzon informacionin e tij tek Samsung për të ri/kontrolluar nëse blerja është e vlefshme dhe brenda afatit të planifikuar - nga data 23 prilli deri më 15 korrik 2018 ose deri në fund përfundim të stokut gjendje dhe klienti jep gjithashtu të konfirmimin e tij/saj për përdorimin e të dhënave personale të tij/saj në përputhje me këto terma dhe kushte.

Nëse blerja e pajisjes është e saktë dhe e konfirmuar, blerësi do të pranojë në adresën e tij ushqyesin pa kabëll në periudhën brenda 20 ditëve të punës nga dita e regjistrimit të suksesshëm të pajisjes. Klienti do të njoftohet për këtë, duke dërguar një mesazh në adresën e postës elektronike të deklaruar në regjistrim. Konfirmimi i Termave dhe Kushteve është i detyrueshëm në mënyrë që procesi të përfundojë.

Blerësi gjithashtu mund të kontrollojë në mënyrë të pavarur statusin e pajisjes, duke futur adresën e e-mailit të regjistrimit dhe fjalëkalimin (kodin) e marrë gjatë regjistrimit.

## 5. PËRDORIMI I TË DHËNAVE PERSONALE

Të dhënat personale të klientëve, që regjistrojnë të dhënat e tyre në një faqe - mikrofaqe do të grumbullohen dhe përpunohen në përputhje me politikat e Samsung për privatësinë dhe mbrojtjen e të dhënave personale dhe termave dhe kushteve, si dhe me rregulloret përkatëse të Republikës së Shqipërisë për mbrojtjen e të dhënave personale.

Të dhënat personale të klientit do të mblidhen për të kontrolluar nëse janë plotësuar kushtet për pjesëmarrje në këtë promovion, si dhe për të përcaktuar adresën e saktë për dërgimin e ushqyesit pa kabëll.

Të dhënat personale të klientit të mbledhura në kuadër të këtij promovioni, do të jenë në dispozicion për subjektet e mëposhtëm:

- Samsung Electronics Austria GmbH, në cilësinë e Mbledhësit të të Dhënave,
- Kompania e sigurimeve Uniqa, në cilësinë e përpunuesit të të Dhënave

Mbledhësi i të dhënave dhe përpunuesi i të Dhënave, i trajtojnë këto të dhëna në përputhje me politikat e Samsung për privatësinë dhe mbrojtjen e të dhënave personale dhe bazuar me rregulloret përkatëse të Republikës së Shqipërisë dhe nuk i lënë të dhënat në dispozicion të palëve të treta.

Grumbullimi i të dhënave personale të klientit në kuadër të këtij promovioni është vullnetar. Nëse klienti vendos të mos ndajë të dhënat e tij personale me Samsung, ai nuk do të ketë të drejtën të marrë pjesë në këtë promovion dhe as të marrë dhuratë një ushqyes pa kabëll.

Nëse të dhënat personale të klientit janë të paplota, të pasakta ose të papërditësuara, me kërkesë të klientit (pronari i të dhënave), Mbledhësi i të Dhënave duhet të shtojë, ndryshojë ose fshijë të dhënat personale të klientit.

## E DREJTA PËR TË NDRYSHUAR KUSHTET E PËRDORIMIT

Samsung rezervon të drejtën për të ndryshuar këto terma dhe kushte në çdo kohë, me detyrimin për t'i bërë këto ndryshime të njohura publikisht pa vonesë. Nëse këto ndryshime, përfshijnë një ndryshim të kushteve të përdorimit të të dhënave personale, Samsung do të kërkojë pëlqimin e klientëve që kanë ndarë të dhënat e tyre personale në kuadër të këtij promovimi.